

Marrëveshje e Mirëkuptimit

në mes të

Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”

dhe

Akademisë Diplomatike të Kosovës

Universiteti i Prishtinës dhe Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës pajtohen të nënshkruajnë Marrëveshjen e Mirëkuptimit me qëllim të bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të përvojave në fushën e diplomacisë dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare, të drejtës ndërkombëtare dhe të disiplinave të tjera akademike.

Neni 1.

Universiteti i Prishtinës dhe Akademia Diplomatike do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e ligjëruesve, ofrimin e ligjëratave në lëmin e diplomacisë, drejtës ndërkombëtare, historisë moderne politike, si dhe në studimin dhe hulumtimin e temave me interes të përbashkët. Institucionet do të bashkëpunojnë dhe do t'i ofrojnë në asistencën teknike gjatë organizimit të ngjarjeve me interes të përbashkët.

Neni 2.

Institucionet do të ofrojnë ligjëratat, konferenca dhe seminare për kandidatët në tema me interes të përbashkët në hapësirat e Universitetit të Prishtinës dhe të Akademisë Diplomatike.

Neni 3.

Universiteti i Prishtinës do të ofrojë ligjërues nga Fakulteti Filozofik, Fakulteti Juridik, Fakulteti Filologjik dhe Fakulteti Ekonomik. Akademia Diplomatike do të sigurojë ligjërues nga radhët e trupit diplomatik të akredituar pranë Republikës së Kosovës, nga radhët e diplomatëve të Republikës së Kosovës si dhe nga institucionet si motra ndërkombëtare.

Neni 4.

Të dy institucionet do të lehtësojnë publikimin e punimeve nga të dy partnerët në organet respektive institucionale, si dhe të teksteve me interes nga institucione të tjera publike apo private, qofshin ato vendore apo ndërkombëtare.

Neni 5.

Universiteti i Prishtinës dhe Akademia Diplomatike Republikës së Kosovës do të shkëmbejnë informacione me interes të përbashkët, përfshirë edhe pjesëmarrjen në takimet apo konferencat ndërkombëtare

Neni 6.

Ky dokument përbën marrëveshjen e plotë në mes palëve. Marrëveshja nuk konsiderohet kontratë obliguese financiare, ajo është dizajnuar për të lehtësuar bashkëpunimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.

Neni 7.

Marrëveshja e Mirëkuptimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi për pesë vite. Marrëveshja mund të ndërpritet nga njëra prej palëve nënshkruese, me shkrim së paku 120 ditë para ndërprerjes. Aktivitetet e filluara para kërkesës me shkrim për ndërprerje të marrëveshjes, do të përfundohen sipas planit në kuadër të afatit kohor prej 120 ditësh, përveç rasteve kur palët pajtohen për të marrë vendim tjetër.

Neni 8.


Marrëveshja mbetet në fuqi në mënyrë automatike edhe për pesë vite të ardhshme nëse palët nuk fillojnë procedurën e ndërprerjes së marrëveshjes.

Prishtinë, më 11.03.2013



Prishtinë, më 11/03/2013

Akademia Diplomatike e Kosovës

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"


.....
Ambasadori Albert Prenkaj

Drejtor



.....
Prof. Dr. Ibrahim Gashi
Rektor